



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2025/0403**  
**Data e Vendimit: 30.05.2025**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Phantom Solutions” SH.P.K. kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me spaleta për PK-në” me numër prokurimi 214-25-3276-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Policia e Kosovës, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 30.05.2025, mori këtë:

### **Vendim**

**I.** Hedhet si jashteafatshme, ankesa e OE “Phantom Solutions” SH.P.K me nr. të protokollit 2025/0403, e datës 23.05.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me spaleta për PK-në” me numër prokurimi 214-25-3276-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Policia e Kosovës, në cilësi të AK-së.

**II.** I lejohet, autoritetit kontraktues- Policia e Kosovës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet.

### **Arsyetim**

Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 23.05.2025, ka pranuar ankesën e OE “Phantom Solutions” SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me spaleta për PK-në” me numër prokurimi 214-25-3276-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Policia e Kosovës në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 18.04.2025, PK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë ndërkaq me datën 14.05.2025 AK ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, ndërsa me datën 26.05.2025 është planifikuar hapja e ofertave.

Operatori Ekonomik “Phantom Solutions” SH.P.K me datën 21.05.2025 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Vendimi i AK-së është publikuar me datën 22.05.2025.

Ankuesi (me të dhëna si më lartë) ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 23.05.2025 me numër protokolli 0403/2025.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vërtetohet se OE kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse me datën 18.04.2025 është publikuar njoftimi për kontratë, hapja e ofertave është planifikuar të bëhet me datën 26.05.2025 ndërsa kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 21.05.2025, që njëherësh ankesa është jashtë afatit ligjor prej 5 ditësh për dorëzim të KR kundër njoftimit për kontratë. OE “Phantom Solutions” SH.P.K me datën 23.05.2025 me numër protokolli 403/25.

OSHP sqaron se kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Sipas nenit 60 pika 1 të Rregullores për Prokurimin Publik, Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

*a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.*

Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se kërkesa për rishqyrtim e parashtruar në Autoritetin Kontraktues me datën 07.04.2025 është parashtruar jashtë afatit ligjor, dhe jo ashtu siç është paraparë në nenin 60 paragrafi 1 pika a) të Rregullores për Prokurimin Publik.

**-Përfundim-**

Neni 108/A paragrafi 3.3 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: “...3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave”.

Autoriteti kontraktues- Policia e Kosovës, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me spaleta për PK-në” me numër prokurimi 214-25-3276-1-2-1, përkitazi me këtë

ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu zyra për pranimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi për pagesën e tarifës me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - PHANTOM SOLUTIONS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: